



AMBIENTI
KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 1308

DATA 08.06.2026

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, dhe rregulloren e brendshëm për rregullimin e procedurave te konkursit nr 3090 e datës 21.11.2025 Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 09.06.2026, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Arkëtar/e - 1 pozitë

Vendi punës : Klinikë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koeficienti i pagës : 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në dy kopje, kopjen e parë ia dorëzon palës, ndërsa kopjen tjetër e mbanë si dëshmi dhe e arkivon.
2. Në fund të çdo dite të punës printon "Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitke" dhe i shton në programin e financave si "Mandat Arkëtim".
3. Në fund të ditës përpilon ditarin e arkës mbi të hyrat dhe të dalurat dhe ia bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar, saldon e deponon brenda ditës në xhirrologarinë bankare të ndërmarrjes.
4. Është i/e obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve financiare të arkës për të cilën vendos kontabilisti.
5. Kujdeset për mjetet e pranuar duke i verifikuar me pajisje adekuate.
6. Jep përgjegjësi për çdo pagesë të cilën e lëshon tek personat e pa autorizuar.
7. Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të ZKF.
8. Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore.
9. Arkëtarët pranojnë mjetet e inkasuara nga mbledhësit e boxhëve inkasantët.
10. Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme, përparësi Diplomë Universitare;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar ;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 09.06.2026 deri me 24.06.2026 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.